# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5888
E enjte, 26 shtator 2019
çmimi 0.40 €

## Thaçi takon Trumpin, e falënderon për mbështetjen e ShBA-së

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË MËRKURËN KA NISUR FUSHATA ZYRTARE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT FAQE 4-5

# NIS 'GJAHU' PËR VOTA












Fushata zyrtare për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit ka nisur të mërkurën me premtime madhore nga subjektet politike dhe kandidatët për kryeministër. Përveç premtimeve për luftim të korrupsionit dhe fuqizim të sundimit të ligjit, liderët partiakë kanë premtuar mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik si dhe janë premtuar miliona euro investime në arsim dhe shëndetësi. Po ashtu, në hapje të fushatës janë bërë zotime për ruajtje të raporteve miqësore me ShBA-në dhe BE-në. Në tubimet elektorale nuk kanë munguar as akuzat e ndërsjella në mes të subjekteve politike

## Mirëpritet përfshirja e luftimit të korrupsionit në programet e partive

Është mirëpritur përfshirja e luftimit të krimit dhe korrupsionit në programet e partive politike për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Në tryezën "Zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë së Kosovës", ambasadori britanik Nicholas Abbott dhe shoqëria civile kanë vlerësuar se nuk mjaftojnë vetëm deklarimet për t'i luftuar dukuritë negative. Sipas tyre, subjektet politike deklarimet gjatë fushatës për sundim të ligjit duhet t'i përcjellin me masa konkrete që do t'i ndërmarrin në këtë drejtim





## Hahni përshëndet votimin e komitetit LIBE për liberalizim të vizave për Kosovën

FAQE 7

### OPINION

**PAQJA ME KORRUPSIONIN**

F. 10



Shkruan: Ragip SHALA

### AKTUALE



**HARADINAJ FALËNDERON GJERMANINË PËR QËNDRIMIN E PALËKUNDUR KUNDËR IDESË PËR NDRYSHIMIN E KUFIJVE** F. 7

**KLINIKA E ALERGOLOGJISË HAP HAPËSIRA TË REJA MODERNE** F. 6

### EKONOMI

**ARKEP-I: PAS PERIUDHËS TRANSITORE TË GJITHË NUMRAT E 'Z-MOBILE'-S DO T'I KALOJNË TELEKOMIT** F. 9

**NGROHJA E QYTETIT NIS PUNËN MË 15 TETOR, ENDE NUK DIHET A DO TË KYÇET 'KALABRIA'** F. 9

### KULTURË

**LIBËR ME INTERES GJUHËSOR DHE LETRAR**

F. 13



Shkruan: Maxhun OSMANAJ

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kosova merr kryesimin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Për herë të parë në histori Kosova ka marrë kryesimin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Këtë e ka bërë me dije ministri në largim i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i cili e ka kryesuar të mërkurën këtë konferencë. "Ky është një hap i madh për Kosovën për të treguar lidership rajonal. Unë sot pata nderin të kryesoj këtë konferencë të rëndësishme. Në takim morën pjesë një numër i madh ministrash të punëve të jashtme për ta diskutuar bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Është një moment krenarie për Kosovën dhe mua për të udhëhequr për një vit organizatën më të madhe dhe më të rëndësishme politike në rajonin tonë që bashkon Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën, Kroacinë, Slloveninë, Malin e Zi, Serbinë, Rumaninë, Greqinë, Turqinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë dhe vendin tonë, Kosovën", ka shkruar Pacolli në profilin e tij në "Facebook".



# Thaçi takon Trumpin, e falënderon për mbështetjen e ShBA-së

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka shprehur presidentit amerikan, Donald Trump, mirënjohjen e popullit të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme nga ShBA-ja që ka qenë përcaktuese, fillimisht për mbijetesë, më vonë për jetësimin e aspiratës për liri dhe pavarësi



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, cili po qëndron në Nju Jork, është takuar me presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump dhe Zonjën e Parë, Melania Trump. "Kënaqësi e veçantë ta takoj përsëri presidentin e ShBA-së, Donald Trump dhe Zonjën e Parë, Melania Trump, dhe ta shpreh mirënjohjen e popullit të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo mbështetje ka qenë përcaktuese, fillimisht për mbijetesë, e më vonë për jetësimin e aspiratës për liri dhe pavarësi", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se mbështetja gjithëpërfshirëse amerikane është jetike për ruajtjen e paqes dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor dhe në mbarë Evropën.

"Nuk do të lejojmë që të cenohet kurrë marrëdhënia speciale që kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar presidenti Thaçi.

Në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, përveç presidentit Thaçi, ka marrë pjesë edhe ministri i Jashtëm në Qeverinë në largim të Kosovës, Behgjet Pacolli.

Me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, është takuar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ka takuar edhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e shkëlqyer me NATO-n dhe KFOR-in si dhe për procesin e transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës.

Presidenti Thaçi ka theksuar se institucionet e Kosovës kanë bashkëpunim të shkëlqyer me NATO-n, e cila është garantuesja e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

"KFOR-i vazhdon të kryejë një punë të mrekullueshme në Kosovë", u shpreh presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi, po ashtu, ka theksuar se procesi i transformimit të FSK-së në ushtri është duke shkuar sipas dinamikës së përcaktuar nga institucionet e Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. "FSK-ja sot është një forcë profesionale, e standardeve të NATO-s, e trajnuar nga NATO, forcë shumetnike e që angazhohet për përfaqësim të barabartë gjinor", ka thënë presidenti Thaçi.

Sekretari i përgjithshëm Jens Stoltenberg ka thënë se NATO-ja mbetet e përkushtuar për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Presidenti Thaçi shtoi se ka ardhur koha që të avancohen marrëdhëniet tona dhe Kosova të anëtarësohet në NATO.

## Jozefina Topalli flet për një lëvizje të re politike



TIRANË, 25 SHTATOR - Ish-kryetarja e Parlamentit të Shqipërisë dhe nënkryetare e Partisë Demokratike, Jozefina Topalli, tha të mërkurën se, pas tri dekadave, politika është në krizë dhe se vendi është pa përfaqësim. Duke folur para studentëve të Universitetit të Shkodrës, ku iu dha Çmimi i Karrierës, Topalli u bëri thirrje të rinjve për "Një lëvizje të re". "Pas tri dekadave politika është në krizë, vendi është pa përfaqësim. Ekonomia nuk ec. Nuk ka as qeveri dhe as opozitë. Ata kanë deformuar demokracinë e brishtë. Ata, ose bëjnë pazare, ose bëjnë shantazhe ndaj njëri-tjetrit. Është më mirë të ikin '4 shahistët' e të rrinë shqiptarët. Nëse forcat e vjetra nuk reformohen, ka vetëm një zgjidhje: 'Një lëvizje e re'. Lëvizje për ndryshim. Dhe mendimi im është te të rinjtë e të rejat, dhe ju që keni gjithmonë zemrën e re", tha ajo, ka njoftuar voa.

Topalli u bëri thirrje të rinjve që të bëhen autorë të fatit të tyre dhe t'i largohen dëshpërimit. "Çfarë e bën këtë vend të veçantë jeni Ju. Mos e harroni këtë. Ata që janë në krye të partive kanë frikë nga ju. Më besoni mua. Mos lejoni më që t'u heqin fëmijët nga shtëpia e t'ua hedhin në emigracion. Mjegulla nuk mund që të na errësojë përjetë shikimin. Ndoshta ndonjë nga të rinjtë këtu do ta fillojë lëvizjen për ndryshim, e ndoshta nesër do të jetë në Parlament për t'i kthyer vendit e Kuvendit shpresën e dinjitetin. Ndoshta nuk do të jetë në Kuvend, por do të jetë në bashkinë e tij për t'i dhënë shpresë qytetit. Do të jetë në punën e tij për t'i dhënë jetë e perspektivë familjes. E si ju në Shqipëri ka me mijëra. Përfytyrojeni kur të bashkohemi të gjithë bashkë. Që vendit t'i kthehet shpresa, të rinjve mundësia për punësim, të moshuarve një pension më dinjitoz, shëndetit t'i jepet kujdesi e shërbimi i duhur, e në fytyrat e njerëzve të kthehet buzëqeshja. Mjaft me dëshpërim. Bëhuni autorë të fatit tuaj", ka thënë Topalli.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbahet tryeza me temë "Zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë së Kosovës"

# Mirëpritet përfshirja e luftimit të korrupsionit në programet e partive

**Është mirëpritur përfshirja e luftimit të krimit dhe korrupsionit në programet e partive politike për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Në tryezën "Zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë së Kosovës", ambasadori britanik Nicholas Abbott dhe shoqëria civile kanë vlerësuar se nuk mjaftojnë vetëm deklarimet për t'i luftuar dukuritë negative. Sipas tyre, subjektet politike deklarimet gjatë fushatës për sundim të ligjit duhet t'i përcjellin me masa konkrete që do t'i ndërmarrin në këtë drejtim**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka mirëpritur deklarimet e partive politike për sundim të ligjit dhe luftimin e korrupsionit gjatë fushatës elektorale. Në tryezën me temë "Zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë së Kosovës" të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe ambasadori britanik, Abbott ka thënë se në luftimin e dukurive negative nuk janë të mjaftueshme vetëm deklaratat. "Në këtë kohë fushate elektorale më vjen mirë të dëgjoj që sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe dukurive të tjera negative është në programet e pothuajse të gjitha partive politike. Nuk është e mjaftueshme që të kemi vetëm deklarata për luftim të korrupsionit. Qytetarët e këtij vendi kanë nevojë të dëgjojnë cilat janë masat konkrete që partitë politike do t'i ndërmarrin në këtë drejtim", ka deklaruar Abbotti. Ai ka lavdëruar Këshillin Prokurorial për hartimin e Rregullores për emërimin e kryeprokurorëve. Megjithatë, sipas tij, sistemi prokurorial duhet t'i adresojë çështjet në rastet kur prokurorët e shtetit atakohen apo denigrohen publikisht nga politikanët, si dhe të ketë më shumë rezultate konkrete në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar të profilit të lartë.

Drejtoresha ekzekutive e GLPS, Arbëresha Loxha, ka vlerësuar se sundimi i ligjit është thelbi i demokracisë. Sipas saj, Kosova duhet të jetë në pronësi të qytetarëve e jo në pronësi të politikanëve të korruptuar. "Sundimi i ligjit është thelbi i demokracisë, i të drejtave të njeriut, imazhit dhe shtetësisë tonë. Ne duam një Kosovë në pronësi të vet qytetarëve të saj dhe së ardhmes së saj evropiane, e jo në pronësi të politikanëve të korruptuar, të sistemeve të drejtësisë të paaftësuara dhe të kontrolluara, si dhe të institucioneve jollogaridhënëse. Ne duam një Kosovë ku institucionet e saj qeverisen nga ligji dhe barazia e të gjithë qytetarëve", është shprehur ajo.

Kurse ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili ka thënë se është i lumtur që mandatin e ka përmbyllur me finalizimin e projektit të sistemit informativ ligjor. Sipas tij, ky është një projekt shumë i rëndësishëm për jetën parlamentare dhe demokracinë e vendit, pasi që garanton transparencë maksimale për qytetarët. "Jam i lumtur që mandatin tim si kryeparlamentar e përmbylla me finalizimin e projektit të sistemit informativ ligjor. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për jetën parlamentare dhe demokracinë tonë, pasi që garanton transparencë maksimale për qytetarët. Është një model i suksesshëm i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shërbim të qytetarëve, i mbështetur nga Qeveria e Norvegjisë, që Kuvendin e Kosovës e bën kampion rajonal të transparencës", ka thënë Veseli, duke shtuar se si kryeparlamentar e ka promovuar gjithmonë qeverisjen elektronike si instrument kryesor që çon drejt rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. "Këtë arrita ta bëj në Kuvendin e Kosovës. Si kryeministër do ta bëj në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës!", ka deklaruar Veseli.

Pjesë e kësaj tryeze kanë qenë edhe kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni. I pari ka diskutuar për veprimet operative të Prokurorit të Shtetit, me theks të veçantë për luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimeve të të gjitha llojeve në Kosovë, pavarësisht se nga cili nivel vijnë dhe origjinës së tyre institucionale apo politike, duke përmendur raste të shumta. Ai ka venë në pah hapatinstitucionalë për mbrojtjen dhe sigurinë e pavarësisë së prokurorëve si dhe aktakuzat e ngritura për profilet e larta të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kurse kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka theksuar rëndësinë e madhe të respektimit të parimeve të mosndërhyrjes së askujt në sistemin prokurorial, duke nxjerrë në pah disa të gjetura në analizën e GSJP-së, të cilat i ka cilësuar si të paqëndrueshme lidhur me rastet e evidentuara. Po ashtu, ai ka prezantuar një sërë faktesh të shkruara për proceset transparente dhe zbatimin e drejtë të akteve ligjore dhe nënligjore nga KPK-ja, duke treguar se emërimet kanë qenë të bazuara ligjërisht, të drejta dhe meritore, si dhe reagimet e Këshillit në mbrojtje të ligjshmërisë pas shkeljeve të bëra nga prokurorët dhe ndëshkimin e veprimeve joetike, si dhe hapat e ndërmarrë për fuqizimin e transparencës, efikasitetit, integritetit, pavarësisë dhe paanshmërisë së përgjithshme të sistemit prokurorial.




## Ambasadori Kosnett: Prioritete për Kosovën janë edukimi dhe rinia



PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se prioritete për Kosovën duhet të jenë edukimi dhe rinia. Kosnett ka thënë kështu përmes një postimi në rrjetin social "Twitter". "I lumtur ta shoh industrinë e filmit dhe studentët që bashkëpunojnë gjatë shfaqjes së filmave nga projekti i Qendrës Kinematografike Kosovare. Edukimi dhe rinia janë prioritete për Kosovën. Kjo është një mënyrë për t'i inspiruar të rinjtë gjatë rritjes së industrisë së filmit", ka shkruar Kosnett.

Të mërkurën ka nisur fushata zyrtare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit

# Nis ‘gjahu’ për vota

**Fushata zyrtare për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit ka nisur të mërkurën me premtime madhore nga subjektet politike dhe kandidatët për kryeministër. Përveç premtimeve për luftim të korrupsionit dhe fuqizim të sundimit të ligjit, liderët partiakë kanë premtuar mirëqenie sociale, zhvillim ekonomik si dhe janë premtuar miliona euro investime në arsim dhe shëndetësi. Po ashtu, në hapje të fushatës janë bërë zotime për ruajtje të raporteve miqësore me ShBA-në dhe BE-në. Në tubimet elektorale nuk kanë munguar as akuzat e ndërsjella në mes të subjekteve politike**



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka zgjedhur vendlindjen e vet, Mitrovicën, për ta bërë hapjen e fushatës zyrtare për zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Para mijëra simpatizantëve të mbledhur në Sheshin "Meh Uka", Veseli ka thënë se është në qytetin e vet të dashur, në vatrën e atdhetarisë, në djepin e Isa Boletinit për ta filluar suksesshëm fitoren e madhe të PDK-së. Sipas tij, Kosova është mirë vetëm kur Mitrovica është mirë. "Unë, biri juaj, kam ardhur sot këtu në Mitrovicë për ta nisur me këmbë të mbarë këtë rrugëtim të ri të Kosovës dhe për ta filluar suksesshëm fitoren e madhe të Partisë Demokratike të Kosovës. Kam zgjedhur Mitrovicën për ta përcjellë qartë dhe fuqishëm mesazhin e Kosovës dhe të Partisë Demokratike: se Kosova është mirë vetëm kur Mitrovica është mirë. E Kosova dhe Mitrovica janë mirë kur ky vend i bekuar nga Zoti zhvillohet dhe ndërtohet më shumë edhe kur qytetarët tanë janë më të kënaqur me jetën e tyre dhe me shtetin e tyre", ka deklaruar Veseli.

Ai ka thënë se 6 tetori është ditë historike për Kosovën sepse qytetarët do t'i thonë po vizionit për ekonominë e dijes dhe inovacionit, luftës kundër korrupsionit dhe nepotizmit si dhe partneritetit të përjetshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. "Më 6 tetor do ta festojmë fitoren e Partisë Demokratike të Kosovës, fitoren e Kosovës, fitoren e të rinjve tanë të mrekullueshëm, vajzave dhe djemve që ëndrrat e tyre do t'i realizojnë në shtetin që meritojnë. Fitoren e grave dhe burrave, nënave dhe baballarëve, nxënësve dhe studentëve, profesorëve dhe intelektualëve, minatorëve, fermerëve, ndërmarrësve, inovatorëve dhe punëtorëve të palodhshëm e të ndershëm. Sepse, ju e dini, kur fiton Partia Demokratike e Kosovës, fitojnë të gjithë. Fiton Kosova! E për të fituar Kosova, duhet të bëhemi bashkë", ka thënë Veseli, duke shtuar se nuk duhet të ketë ndarje, por bashkim me vizionin e PDK-së për ta ndërtuar të ardhmen. "Të ardhmen e një Kosove që mbron territorin dhe sovranitetin dhe që fuqizon partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Të gjithë ne duhet të bëhemi bashkë si dikur, si atëherë kur rrezikoheshim dhe të vendosim me tërë fuqinë për ta bërë Kosovën shtet të cilin e kemi ëndërruar", ka thënë ai.



### Kurti: Një diell i ri do të lindë pas 6 tetorit për Kosovën

Edhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) e ka hapur fushatën zgjedhore në qytetin e Mitrovicës në palestrën "Minatori" në prani të mijëra aktivistëve dhe simpatizantëve. Kandidati për kryeministër i LV-së, Albin Kurti, ka thënë para të pranishmëve se 126 është ritmi i Lëvizjes i Vetëvendosjes, i Mitrovicës, i Kosovës dhe ritmi i fitores. "Është momenti i fundit për ta shpëtuar vendin nga politikanët e pangopur dhe të korruptuar. Neve nuk na duhet asnjë sondazh sepse koha jonë ka ardhur. Një diell i ri do të lindë pas 6 tetorit për Mitrovicën dhe për Kosovën", është shprehur Kurti. Më tutje, ai ka folur për rolin që ka luajtur Vetëvendosja në kundërshtimin e proceseve të dëmshme për Kosovën që nga Plani i Ahtisarit e këndej. Kurti ka bërë thirrje për mobilizim në zgjedhjet e 6 tetorit. "Më 6 tetor do të dalim në votime, do ta votojmë numrin 126 dhe do ta hapim një kapitull të ri për Kosovën me faqe të bardhë për republikën", është shprehur Kurti, duke shtuar se ka ardhur koha për arsim dhe edukim cilësor, për zhvillim, për sundim të ligjit. Ai ka premtuar miliona euro investime për arsim, shëndetësi e ekonomi. "Me LV-në në qeveri investimet kapitale në arsim do të rriten për 160 milionë euro për katër vjetët e ardhshëm, do të bëjmë sistem shëndetësor të kompletuar me rritje të investimeve prej 120 milionë eurosh", ka thënë Kurti.

### Ahmeti dhe Haradinaj thonë se vetëm koalicioni AAK-PSD mund ta bëjë Kosovën 100 për qind

Ndërsa koalicioni AAK-PSD e ka hapur fushatën zgjedhore në Therandë në sallën "13 Qershori". Në mungesë të liderit të AAK-së dhe kandidatit për kryeministër, Ramush Haradinaj, i cili gjendet në viz-

## Partia Fjala nis fushatën me premtimin për luftim të korrupsionit dhe krimit

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Partia Fjala ka hapur fushatën për zgjedhjet e parakohshme parlamente të 6 tetorit, me premtimin për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe nepotizmin.

Kryetari i kësaj partie, Gëzim Kelmendi, ka thënë se arsyeja që të mërkurën nuk i kanë ftuar qytetarët është pasi e vlerësojnë të tepërt thirrjen e qytetarëve në tubime zgjedhore kur ata për 20 vjet janë mashtruar. Ai ka thënë se partia Fjala ka për synim që ta ndryshojnë mendësinë aktuale politike ku populli është në shërbim të politikës dhe me qeverisjen e tyre politika do të vihet në shërbim të popullit.

Kelmendi ka premtuar përgjysmimin e pagës së qeveritarëve dhe ndaljen e keqpërdorimeve të buxhetit të Kosovës.



itë zyrtare në ShBA, para simpatizantëve dhe anëtarësisë ka folur kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti. Ai ka thënë se Ramushi ka shkuar në Amerikë për të mos lejuar përgatitjen e ndonjë plani për ndarjen e Kosovës. Ahmeti ka bërë thirrje që më 6 tetor të votohet numri 119 në mënyrë që Kosova të jetë shtet 100 për qind. "AAK-ja së bashku me PSD-në i kanë parandaluar disa plane të këqija për Kosovën. Kosova nuk është 100 për qind. Pra, punët nuk janë kryer, por koalicioni AAK-PSD është i vetmi që mund t'i kryejë ato. Ramushi ka shkuar në Amerikë për të moslejuar përgatitjen e ndonjë plani për ndarjen e Kosovës. Lista jonë ka njerëzit më të mirë dhe më të përgatitur. Votojeni koalicionin AAK-PSD më 6 tetor", ka deklaruar Ahmeti.
Kurse anëtari i Kryesisë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme kanë ardhur për shkak të vendosjes së taksës ndaj produkteve të Serbisë, formimit të ushtrisë dhe pengesës për të mos bërë pazare me toka të Kosovës. "Arsyeja që na sollën deri te zgjedhjet e parakohshme ishte taksa, ushtria dhe pengesa për të mos bërë pazare me toka të Kosovës. Ishin vendime që nuk shkuan në favor të atyre që nuk e kanë dashur të mirën e vendit tonë dhe Ramushi me të drejtë ia kthej vendimin sovranit. Sovrani më 6 tetor do të vendosë nëse ato vendime ishin të drejta apo jo? Nëse ju mendoni se Kosova ka pasur të drejtë të ketë ushtri dhe se është i padrejtë copëtimi i Kosovës, e keni shansin historik që të votoni për koalicionin tonë dhe numrin 119", ka deklaruar Haradinaj.




## Limaj: Koalicioni Nisma - AKR - PD do të jetë befasia e 6 tetorit

Ndërkaq koalicioni Nisma - AKR - PD nga salla "1 Tetori" në Prishtinë ka nisur betejën elektorale për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë para një numri të madh të simpatizantëve të koalicionit Nisma - AKR - PD, se ky koalicion do të jetë befasia spektakolare e 6 tetorit. "S'kemi thënë rastësisht se disa herë e kanë shpallur rezultatin, koalicioni ynë do të jetë befasia e 6 tetorit, ku Kosovës do t'i japë një drejtim tjetër. Jemi bashkuar me këtë vizion me energji pozitive. Vendi ynë ka nevojë për bashkim dhe energji pozitive, për njerëz kompetentë, të cilët kanë dëshmuar që e duan atë. Keni dëgjuar e po dëgjojmë një garë kush e do më shumë Kosovën. Na kanë dalë do piqpirika e po na tregojnë kush e do më shumë Kosovën. Ata edhe kur t'i shihni ngrohtë e mirë, pa asnjë telashe, rehat dhe nuk e kursejnë fjalën më të madhe kush e do vendin. Dallimi ynë me ta është se s'ka dikur familjen a vendin. Edhe ne kemi pasur familje, por kur e kemi pasur mundësi të zgjedhim mes familjes dhe atdheut, ne kemi zgjedhur atdheun




më të shenjtë për një njeri se familja, e kur e ka lypur Kosova, ne e kemi sakrifikuar familjen për t'i shërbyer Kosovës. Edhe ne kemi mundur ta zgjedhim duke sakrifikuar vetveten", ka deklaruar Limaj.
Më pas ai e ka ndarë edhe një rrëfim të shkurtër nga e kaluara e vet. "Unë i kam përballuar të gjitha të këqijat dhe kurrë s'kam hequr dorë nga Kosova", ka theksuar Limaj.
Ndërsa presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, nëpërmjet një videomesazhi nga Amerika ka thënë se ky koalicion do ta luajë rolin vendimtar në qeverinë e ardhshme të Kosovës. Ai ka thënë se miqësia me Amerikën do t'i ndihmojë Kosovës që ta ketë vendin e merituar në arenën ndërkombëtare. Pacolli ka thënë se integriteti dhe sovraniteti i Kosovës ruhen vetëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA).
Pacolli nga Nju Jorku është zotuar se koalicioni Nisma - AKR - PD do ta zhvillojë Kosovën dhe do të hapë vende të reja pune. Në anën tjetër, kryetari i Partisë së Drejtësisë (PD), Ferid Agani, ka thënë se koalicioni Nisma - AKR - PD është zgjedhja më e sigurt për të udhëhequr Kosovën. Limaj, Pacolli dhe Agani i kanë ftuar qytetarët ta votojnë numrin 122.

## Osmani: Asgjë nuk mund ta ndalë rrugën tonë të fitores

Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) hapjen e fushatës elektorale e ka bërë në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë mijëra simpatizantë. Me këtë rast, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka falënderuar të pranishmit, duke kërkuar që më 6 tetor të votojnë për numrin 134 dhe Vjosa Osmanin. Ai ka thënë se Vjosa do të jetë kryeministre e Kosovës pas 6 tetorit. "Vjosa Osmani e ka përkrahjen e plotë të LDK-së për të qeverisur mirë vendin dhe për të marrë vendime të mëdha dhe të guximshme. Prandaj u bëj thirrje të gjithëve që më 6 tetor të dalim në zgjedhje dhe të votojmë për qeverisjen tonë të ndershme", ka deklaruar Mustafa.
Kurse kandidatja për kryeministre e kësaj partie, Vjosa Osmani, ka premtuar qeverisje të mirë, sundim të ligjit, zhvillim ekonomik, punësim, arsim cilësor dhe shërbime të mira shëndetësore. "Faleminderit shumë për këtë përkrahje të jashtëzakonshme! Faleminderit LDK! Faleminderit ushtri e Ibrahim Rugovës! Sot jemi më të bashkuar e më të vendosur se kurrë për fitoren e LDK-së dhe të Kosovës. Asgjë nuk mund ta ndalë rrugën tonë të fitores", ka thënë Osmani.




## PEK-u nis fushatën me kritika për klasën politike

**Prishtinë, 25 shtator** - Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK) ka hapur fushatën zgjedhore të mërkurën në Prishtinë, me ç'rast është thënë se të gjitha premtimet e kësaj partie do të realizohen. Kryetari i PEK-ut, Milaim Zeka, ka kritikuar klasën aktuale politike duke thënë se tash e dy dekada e ka vjedhur popullin e Kosovës. "Që 20 vjet kjo klasë politike e shiti tërë pasurinë e këtij vendi. Kjo klasë politike e ka sjellë qytetarin e Kosovës përpara dilemës a ta vrasë veten apo të ikë nga Kosova. Kjo klasë ka bërë që një numër i ushtarëve të UÇK-së ta vrasin veten pas luftës. Kjo klasë e ka poshtëruar Adem Demaçin e shumë njerëz të tjerë duke sjellë ministra e zëvendësministra, njerëz që kanë qenë pjesë e shërbimit sekret", ka deklaruar Zeka para anëtarësisë dhe simpatizantëve të PEK-ut.



# Klinika e Alergologjisë hap hapësira të reja moderne

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Për herë të parë që nga ekzistimi i saj, Klinika e Alergologjisë me Imunologji është bërë me hapësira të reja. Ajo do t'i ketë gjashtë dhoma me nga dy shtretër me nyje sanitare higjienike dhe infrastrukturë përcjellëse moderne. Ky investim Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) i ka kushtuar mbi 150 mijë euro.

Drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se kjo klinikë deri më tani ka punuar vetëm me pacientë ambulatorë pa pasur shtretër dhe mundësi që 13 mjekë t'i shtrijnë dhe trajtojnë pacientët, por kanë trajtuar vetëm rastet ambulatore. "Në vazhdën e investimeve që po bëhen për modernizim të hapësirave të klinikave është edhe renovimi i hapësirave të reja për Klinikën e Alergologjisë me Imunologji, hapësira që kemi krijuar për herë të parë, sepse kanë punuar vetëm me raste ambulatore", është shprehur ai. Sipas tij, tashmë janë krijuar hapësira moderne për punë me stafin mjekësor dhe pacientët që do të kenë mundësi tashmë të kryejnë shërbime jo vetëm ambulatore, por edhe të shtrihen për trajtim. E gjithë kjo është mundësuar falë përkrahjes nga Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë.

Kurse drejtori i Klinikës së Alergologjisë me Imunologji, dr. Dukagjin Zogaj, ka theksuar se deri tani, edhe pse kishin bërë shumë kërkesa, ato nuk ishin realizuar. "Për herë të parë ky menaxhment dhe ministri na kanë përkrahur, duke krijuar




hapësirat më moderne në regjion", ka thënë Zogaj, duke shtuar se tash Klinika ka hapësira për kabinetin për spirometri dhe provokime nga medikamentet.

Deri tani si raste ambulatore në këtë klinikë ishin kryer 30 deri në 40 raste brenda ditës. Në këtë përurim ishte i pranishëm edhe Ardian Ferizi, anëtar i Bordit Drejtues i ShSKUK-së.

# Kryetari i Nismës në Gjakovë takon zjarrfikësit dhe pensionistët, premton mbështetje

GJAKOVË, 25 SHTATOR (ER) - Kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, njëherësh kandidat për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, Fazli Hoxha, së bashku me kandidatët e tjerë për deputetë të Nismës, ka vizituar të mërkurën Brigadën e Zjarrfikësve në Gjakovë për t'i parë nga afër problemet dhe kërkesat sa i përket financimit dhe menaxhimit të Shërbimit Zjarrfikës dhe Shpëtimit. "Ne u garantuam atyre se si deputetë në Kuvendin e Kosovës do të angazhohemi që të jemi zëri i tyre për t'i përfaqësuar interesat e Shërbimit Zjarrfikës dhe Shpëtimit, duke e ditur rëndësinë këtij shërbimi në raste emergjente, në mbrojtje të qytetarëve dhe të pronës. Emergjencat si kjo e zjarrfikësve duhet të vendosen më kryesoret", ka deklaruar Hoxha.

Kandidati Hoxha ka takuar edhe përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve në Gjakovë. Gjatë këtij takimi Hoxha dhe kandidatët e tjerë për deputetë kanë dëgjuar shqetësimet e pensionistëve dhe kërkesat e tyre. "Në këtë takim ramë dakord me pensionistët që të kemi komunikim të vazhdueshëm qoftë si udhëheqje e Nismës në Gjakovë, por edhe si kandidatë për deputetë. U zotuam se do të jemi zëri i pensionistëve në Kuvendin e Kosovës. Koalicioni NISMA-AKR-PD në qeverinë e ardhshme pas 6 tetorit do t'i trajtojë me prioritet kërkesat e pensionistëve në vendin tonë", ka thënë Hoxha.





# Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave po mban ushtrimin 'Shpata e Argjend 2019-2'

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme po mbahet ushtrimi "Shpata e Argjend 2019-2', që po organizohet nga KFOR-i së bashku me institucionet e Republikës së Kosovës. Ky ushtrim ka për qëllim testimin e kapaciteteve të institucioneve të Republikës së Kosovës në komunikim, koordinim dhe bashkëpunim për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Në ushtrim, përveç njësive të KFOR-it, po marrin pjesë: Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe institucione të tjera që kanë rol në Planin e Reagimit Kombëtar.

Ushtrimi po mbahet në të njëjtin kohë në kampin e KFOR-it në "Film City" dhe në Qendrën Operative të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Në fund këtij ushtrimi, më 27 shtator do të mbahet analiza pas veprimit për ushtrimin "Shpata e Argjend 2019-2", për t'i evidentuar mangësitë, të arriturat dhe për të rekomanduar për përmirësimet në të ardhmen.

# Ministri Gashi ndau mirënjohje për Vasfije Krasniqi-Goodman

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Në Teatrin "Bekim Fehmiu" u shfaq "Bisha në Hënë" nga Richard Kalinoski e aktorët që interpretuan në këtë shfaqje ishin të mbijetuarit e luftës së fundit. Pjesë e shfaqjes ishte edhe Vasfije Krasniqi Goodman, viktimë e përdhunimit gjatë luftës në Kosovë. Me këtë rast, ministri Kujtim Gashi ndau mirënjohje për Vasfije Krasniqi-Goodman.

Vasfije Krasniqi Goodman është gruaja e parë nga të dhunuarat gjatë luftës së fundit në Kosovë që ka dalë publikisht në televizion për t'i rrëfyer torturat që ka përjetuar gjatë luftës nga policët serbë.

Ministri Gashi ka thënë se kjo mirënjohje për zonjën Vasfije ndahet për kontributin e veçantë dhe të rrallë për sensibilizimin e opinionit vendor dhe ndërkombëtar përmes artit për përjetimet dhe vuajtjet e mbi 20 mijë grave shqiptare gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë.



Komiteti LIBE voton për, Kosova edhe një hap më afër liberalizimit të vizave

# Hahni përshëndet votimin e komitetit LIBE për liberalizim të vizave për Kosovën




Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian (BE), Johannes Hahn, ka përshëndetur votimin e komitetit LIBE për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ai ka thënë se vendimi i këtij komiteti është vazhdimësi e qëndrimit të Komisionit Evropian për nisjen e negociatave me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Komiteti i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) sërish i ka dhënë dritën e gjelbër procesit të liberalizmit të vizave për qytetarët e Kosovës. Me anë të një shkrimi në rrjetin social në "Twitter", komiteti LIBE ka bërë me dije se në një votim të hapur është marrë vesh që të fillojnë bisedimet me Këshillin Evropian për heqjen e vizave për Kosovën. Sipas këtij njoftimi, 49 vota kanë qenë për, 4 abstenime dhe 13 vota kundër. Mandati do të konfirmohet në një seancë plenare të Parlamentit Evropian. Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian (BE), Johannes Hahn, e ka komentuar vendimin e Komitetit Evropian LIBE, i cili ka rekomanduar nisjen e negociatave me Këshillin Evropian për liberalizimin e vizave.

Hahni në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se e mirëpret këtë vendim, i cili është vazhdimësi e opinionit të Komisionit Evropian. "Mirëpres vendimin e komitetit që është vazhdimësi e qëndrimit të Komisionit Evropian për nisjen e negociatave me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave", ka shkruar Hahni.

Komiteti LIBE është komitet i posaçëm në Parlamentin Evropian për mbrojtje të të drejtave civile dhe të drejtave njerëzore, duke përfshirë ato të minoriteteve. Mandatin e drejtimit të këtij instrumenti të PE-së e ka spanjolli Juan Fernando Lopez Aguilar.

Nëse propozimi kalon edhe në Parlamentin Evropian, atëherë hapet rruga për bisedime me Këshillin Evropian. Pas përfundimit të bisedimeve me Këshillin Evropian pritet që të dilet me një vendim përfundimtar për liberalizimin të vizave. Nuk dihet sa do të zgjasë ky proces.

Seanca plenare në Parlamentin Evropian mbahet muajin që vjen.

Këshilli Evropian kërkon votim unanim për liberalizim të vizave për shtetet. Ajo përbëhet nga 28 anëtarë nga secili shtet në BE. Andaj kërkohet që secili shtet të votojë pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Kosova është shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor pa liberalizim të vizave.

# Haradinaj falënderon Gjermaninë për qëndrimin e palëkundur kundër idesë për ndryshimin e kufijve

NJU JORK, 25 SHTATOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka takuar të mërkurën përfaqësuesin e përhershëm të Gjermanisë në Kombet e Bashkuara, Christoph Heusgen, me të cilin ka diskutuar për proceset politike nëpër të cilat po kalon Kosova, për dialogun me Serbinë, për zgjedhjet e reja në vend dhe për partneritetin strategjik që Kosova e ka ndërtuar, veçmas vitet e fundit me shtetin gjerman. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Haradinaj, e ka falënderuar ambasadorin Heusgen për qëndrimin e palëkundur të Gjermanisë dhe të kancelares Angela Merkel kundër idesë për ndryshimin e kufijve dhe angazhimin konkret për rikthimin e dialogut pa kushte Kosovë - Serbi. "Kosova është e përkushtuar, krah me aleatët strategjikë, që ta vazhdojë rrugën euroatlantike, fuqizimin e brendshëm dhe afirmimin e subjektivitetit të saj ndërkombëtar, si dhe për paqe e stabilitet rajonal", theksoi kryeministri në detyrë, Haradinaj.



# PAQJA ME KORRUPSIONIN



Shkruan: Ragip SHALA

Fjala korrupsion vjen nga latinishtja corrumpere, që do të thotë përkeqësim fizik dhe moral i njeriut. Sikurse në disa gjuhë të tjera, edhe në gjuhën shqipe ka hyrë fjala korrupsion. Termat që përcaktojnë korrupsionin në gjuhë të ndryshme janë: në gjuhën shqipe dhuratë, frëngjisht pot - de vin (got e verës), turko arabe bakshish, anglisht payola, gjermanisht geschenken, sllavisht poklon, italisht regali etj.
Korrupsioni është ves, infeksion që bashkëjeton me shtetin që nga lindja e pronës private, familjes dhe shtetit para erës së re dhe është bartur në të gjitha formacionet social-politike që nga skllavopronaria e deri në kapitalizëm. Meqë korrupsioni përbën një ves shkatërrues që deformon dhe degradon mekanizmin socio-politik të qenies njerëzore, prandaj posstigmatizimit i është shpallur edhe luftë.
Derisa luftërat konvencionale, krahas fillimit, kanë edhe fundin e saj, lufta kundër korrupsionit veçohet e pafund në kohë dhe hapësirë, prandaj është një luftë me përmasa globale. Korrupsioni është i shtrirë në të gjitha shtetet pavarësisht prej formës qeverisëse, zhvillimit ekonomik, madhësisë dhe pozitës gjeografike, prandaj korrupsioni është sanksionuar si vepër penale në të gjitha shtetet.

### Shkaqet e korrupsionit

Janë të shumta shkaqet, dhe të shtresuara ndër shtete të ndryshme, por ndër shkaqet e përgjithshme të korrupsionit janë: keqqeverisja, institucionet shtetërore të dobëta, mungesa e veprimeve preventive të sistemeve politike, pagat e ulëta, aspekti kulturor, mungesa e etikës profesionale, konfliktet e interesit etj.

### Format e korrupsionit

Ndër format e korrupsionit janë: dhurata, falsifikimi i dokumenteve zyrtare, favorizimi, nepotizimi, mashtrimi, zhvatja, abuzimi me fondet publike etj.

### Tipat e korrupsionit

Tipat e korrupsionit janë: korrupsioni i madh, korrupsioni i vogël, publik dhe korrupsioni privat. Korrupsioni i madh ka të bëjë me korruptimin në nivelin e lartë shtetëror, kur zyrtarët e lartë shtetërorë në vendimmarrje shfrytëzojnë pozitat shtetërore për përfitime personale.
Kurse korrupsioni i vogël përbën korruptimin e burokracisë në administratën publike të një shteti të caktuar. Pastaj korrupsioni ndahet në korrupsion aktiv dhe pasiv.
Korrupsioni aktiv është kur një person ofron dhuratë në para apo shërbime të ndryshme, kurse korrupsioni pasiv është kur një person i caktuar i pranon këto oferta.
Korrupsioni si një ves shkatërrues është përhapur në të gjitha shtetet evropiane dhe në shtetet e kontinenteve të tjera. Varësisht nga shtrirja e korrupsionit, ndër shtete ato ndahen në dy grupe: shtetet më pak të korruptuara dhe shtetet shumë të korruptuara. Ndër shtetet më pak ose të pakorruptuara hyjnë: Danimarka, Zvicra, Norvegjia, Suedia, Gjermania, Holanda etj. Kurse shtetet të cilat janë zhytur në korrupsion hyjnë shtetet arabe, afrikane etj. Bashkimi evropian në luftën kundër korrupsionit ka formuar një komision të posaçëm për të hulumtuar dhe elaburuar instrumente të caktuara juridike kundër korrupsionit.
Këshilli i Bashkimit Evropian më 1996 ka miratuar një varg masash kundër korrupsionit siç janë: rezoluta që përmban më se 20 principe për ta luftuar korrupsionin, pastaj Konventa Penale dhe Konventa Civile Kundër Korrupsionit.
Kosova si një ndër shtetet më të reja në kontinentin evropian nuk është kursyer nga korrupsioni për shkak të specifikave të saj ekonomike dhe politike. Janë të shumta shkaqet e shtrirjes së korrupsionit në Kosovë, por ndër shkaqet kryesore konsiderohet moszhvillimi ekonomik që ka rezultuar me një papunësi tejet të lartë.
Përkundër pasurive mbitokësore dhe nëntokësore, Kosova renditet ndër shtetet më të varfra në rajon, prandaj mbase është shndërruar në poligon të përshtatshëm për shtrirjen e korrupsionit. Lufta kundër korrupsionit nuk sjell zhvillim ekonomik, përkundrazi zhvillimi ekonomik lufton korrupsionin. Investimet në bujqësi, në industrinë e lehtë dhe të rëndë do të hapnin vende të reja pune që pastaj do të rezultonte me ngufatjen e korrupsionit.
Kosova si asnjëherë më parë ka nevojë për shtetin social që nënkupton: sigurim shëndetësor për tërë popullatën, shtesa fëmijërore, përkujdesje për shtresat e moshuara, pastaj ulje të kamatave bankare si dhe reforma të përgjithshme.
Përparimi i gjithanshëm ekonomik i Kosovës do ta sillte "kapitullimin" e korrupsionit që do të rezultonte me një paqe?! Pse jo?

# PA PROFILIZIM IDEOLOGJIK PARTIAK DHE PA PËRFUNDIM TË NEGOCIATAVE ME SERBINË, NDRYSHIMI NË KOSOVË S'MUND TË NDODHË



Fadil MALOKU

1. Rëndomë thuhet se elementet kyçe të një partie politike duhet të jenë: ideologjia që ka të bëjë me një kontingjent idesh apo konceptesh që mundohet t'i fuqizojë ajo në publik, pastaj statuti që, në fakt, është një përmbledhje kodesh, qëndrimesh dhe vendimesh ku në mënyrë më të hollësishme përshkruhen format, detyrat, sidomos obligimet e pjesëtarëve të asaj partie si dhe programi politik që duhet të dominohet përmes konkretizimit të një ideje konkrete (p. sh., të drejtat kombëtare, të drejtat sociale, mbrojtja e grave, rinisë, punëtorëve, ndërtimin e shtetit etj.) e cila publikut të gjerë zakonisht i eksplorohet përmes debateve, grupeve parlamentare, medieve, etj. pra formave të ndryshme të "kontaktit", në mënyrë që të arrihet një qëllim i caktuar.
2. E ai qëllim ka të bëjë me marrjen e pushtetit, pra implementimin e këtij programi e ideologjive të pranuara nga qytetarët, në mënyrë që të vazhdohet realizimi i synimeve qofshin ato: sociale, politike, ekonomike, mund të ndodhë edhe kulturore dhe ekologjike. Në realitet duket që kur janë në pyetje organizatat partiake në kushtet dhe rrethanat e një pluralizmi fillestar, siç ishte ai i vendeve të tranzicionit, pra shteteve që në një mënyrë e kishin të realizuar identitetin e tyre kombëtar, pjesa më e rëndësishme apo ajo pjesa më mobilizuese që i fuqizoi masat e gjëra popullore (apo dosido edhe pjesën amorfe të publikut) në projektet nacionale demokratike, na del pjesa e parë, pra elementi ideologjik.
3. Në rastin e Kosovës duket se ky element nuk ishte i dorës së parë meqë procesi i realizimit të identitetit kombëtar kishte mbetur në gjysmë të rrugës dhe, si i tillë, vendin e tij e zuri sintagma kombëtare e cila me vete mori dhe pranoi ideologjinë e secila e mundësoi këtë proces të realizimit (ani pse ende gjysmak, pra jo plotësisht!) në kushte dhe rrethana pak a shumë specifike edhe me vetë faktin se rrugëtimi ishte dybinarësh: ai shtetëror (kombëtar) dhe ai demokratik që është një temë në vete e që me këtë rast nuk mund t'i kushtojmë vëmendje më të gjerë.

## Ngrohja e qytetit nis punën më 15 tetor, ende nuk dihet a do të kyçet "Kalabria"

Prishtinë, 25 shtator - Janë duke u bërë përgatitjet e fundit për të nisur sezoni i ri i ngrohjes në Prishtinë. Zyrtarë nga "Termokos"-i thonë se që nga përfundimi i sezonit 2018/19 janë duke u kryer riparimet e nevojshme për ta nisur sezonin 2019/20. Por, përveç lagjeve ku deri më tani ka ekzistuar rrjeti i ngrohjes, janë duke u bërë përpjekje që këtë vit të kyçen edhe 20 objekte banesore të "Kalabrisë". Zëdhënësja e "Termokos"-it, Afërdita Uka, ka treguar se afati i nisjes së ngrohjes në qytet ligjërisht është data 15 tetor. Por ajo ka shtuar se kjo do të bëhet nëse kushtet klimatike do të jenë në normale. "Sezoni ngrohës duhet të fillojë më 15 tetor", ka thënë Uka për "Gazetën Express".



# ARKEP-i: Pas periudhës transitore të gjithë numrat e 'Z-Mobile'-s do t'i kalojnë Telekomit

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka njoftuar se numeracioni i cili është aktualisht në dispozicion nga Dardafone.net (Z-Mobile), pas kalimit të periudhës transitore, do t'i kalojë për përdorim Telekomit të Kosovës. ARKEP-i ka sqaruar se shfrytëzuesit nuk do të kenë ndërprerje të shërbimeve

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 25 shtator** - Bordi Drejtues i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në mbledhjen e mbajtur të mërkurën, pas analizimit të situatës së krijuar si rezultat i mosvazhdimit të raportit komercial ndërmjet operatorit të rrjetit të telefonisë Telekomi i Kosovës dhe operatorit virtual të rrjetit Dardafon.net (Z-Mobile), i cili raport ka qenë i bazuar në marrëveshje komerciale, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe rregullative aktualisht në fuqi, si dhe pas marrjes së opinioneve profesionale të Entit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikime Elektronike (Body of European Regulators for Electronic Communications - BEREC), kompanisë së specializuar për rregullimin e telekomunikacionit me bazë në Bruksel "Cullen International" si dhe trajtimit të kësaj çështje brenda autoritetit, ka marrë vendim që me qëllim të dhënies së mundësisë së përdoruesve fundorë për vijimësi të shërbimeve, numeracioni i cili është aktualisht në dispozicion për nevoja të operatorit virtual Dardafone.net, pas kalimit të periudhës transitore, t'i kalojë për përdorim operatorit amë - rrjetit të telefonisë, përkatësisht Telekomit të Kosovës. "Shfrytëzojmë rastin t'ua bëjmë me dije shfrytëzuesve të | telefonisë mobile që shërbimi për ta nuk do të ketë ndërprerje për asnjë çast. ARKEP-i në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të cilat dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji bazë për Komunikimet Elektronike mbetet i përkushtuar në vazhdimësi për rregullimin e tregut në kuadër të mandatit që ka dhe mbi bazën e parimeve themelore të cilat garantojnë konkurrencë efektive, transparencë, mosdiskriminim dhe mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve", është thënë në komunikatën e ARKEP-it.




# Ministri Lluka nënshkruan në Vjenë marrëveshjen e parë në histori për zhvillimin e projektit energjia nga dielli

**Vjenë, 25 shtator (ER)** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se me marrjen e mandatit të ministrit dy vjet më parë pati dhënë zotim para qytetarëve të Kosovës për zhvillim ekonomik të vendit, krijim të kushteve për investime të huaja direkte, diversifikim të resurseve energjetike dhe promovim të energjisë së pastër me qëllim të mbulimit të nevojës për konsum të brendshëm, respektivisht zvogëlimin e importit dhe ndërprerjen e humbjeve të biznesit si pasojë e furnizimit jo të rregullt me energji.

Në Vjenë të Austrisë Lluka ka nënshkruar marrëveshjen e parë në histori të Republikës së Kosovës me zëvendëspresidenten e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (pjesë e Bankës Botërore), Georgina Baker, për zhvillimin e projektit energjia nga dielli me kapacitet 50MW, përmes partneritetit publiko-privat mbi baza konkurruese. "Zhvillimi i projekteve të tilla të partneritetit publiko-privat, përveçse do ta fuqizojë tutje aktivitetin ekonomik të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike e vende të reja të punës, do të ndikojë drejtpërdrejt në ulje të çmimit të energjisë për konsumatorë, rritje të transparencës dhe përmbushje të obligimeve të Republikës së Kosovës karshi direktivave të Bashkimit Evropian për diversifikim të gjeneratorëve të energjisë elektrike", ka shkruar Lluka në llogarinë e vet në "Facebook".



Aktuale / PDK-ja në koalicion me ligjin e me sovranin për t'i eliminuar shpërdorimet (2)

# Faqe e re e zhvillimit ekonomik dhe politik

**Qeveria, me kryeministër Kadri Veselin, nuk do t'i lejojë më punësimet pa kritere ligjore dhe mbi bazën e ndërhyrjeve korruptive, politike, farefisnore, familjare, partiake etj. Ky shpërdorim eklatant ka marrë shtrirje të gjerë, sidomos në vitet e fundit**



Hasan MUJAJ

Erdhi koha e ndryshimeve të mëdha në ekonominë dhe në politikën e Kosovës. Ajo (koha) do të fillojë më 7 tetor të këtij viti. Ndryshimet e mëdha, tejet të mëdha ekonomike e politike që do të ndodhin në Kosovë në favorin e qytetarëve të saj, janë përmbledhur në projektin e zbatueshëm në praktikë të PDK-së, i cili kudo po pritet me ngazëllim nga mijëra e mijëra qytetarë. Projekti i ri i Qeverisë së re me kryeministër Kadri Veselin do të sjellë kthesa të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe të zbatimit të ligjit në të gjitha fushat e veprimtarisë sepse:

kryeministri Veseli ka përvojën e udhëheqjes shtetërore të nivelit më të lartë, e cila (përvoja) duhet të jetë kusht i pakapërcyeshëm për postet drejtuese;

ai është denjësisht i përkushtuar për funksionimin e shtetit mbi bazat ligjore dhe kundërshton të gjithë ata që pandehen si të dyshuar për shkelje ligji shpërdorimesh të ndryshme; këtë përkushtim e dëshmoi me faktin se, pa rënë Qeveria, liroi nga postet drejtuese disa zyrtarë të lartë të partisë politike që e drejton vetë (PDK), të cilët kanë aktakuza për shkelje ligji; kjo nuk ndodhi nga liderët e tjerë politikë;

është i vendosur për t'i ndjekur e për t'i mënjanuar dukuritë negative, sidomos korrupsionin e nepotizmin për të cilat dukuri Kosova ka marrë shumë kritika nga aleatët ndërkombëtarë;

përforcoi ndërlidhjen e bashkërendimit politik me ShBA-në pas reagimesh të disa zyrtarëve të lartë amerikanë për një lloj ftohjeje raportesh me Kosovën;

kërkoi që të përgjigjen para drejtësisë të gjithë ata që u morën me mashtrime e me falsifikime rreth statusit të veteranëve;

në fjalimet publike parazgjedhore është korrekt ndaj oponentëve politikë, nuk bën improvizime, fyerje e kritika ndaj kandidatëve të tjerë për kryeministër sikundër veprojnë disa liderë të tjerë, porse pasqyron planet e zhvillimit konkret të vendit madje edhe sipas afateve kohore të zbatimit të tyre;

kryeministri Kadri Veseli ka të drejtën morale, ligjore, politike etj. të merret me antikorrupsionin ngase nuk është i korruptuar etj.

Këto janë vetëm disa nga përparësitë e liderit apodiktik e persuasiv të PDK-së për kryeministër të Kosovës në krahasim me të nominuarit e tjerë për këtë post.

Kjo është në pika të shkurtra vetëm një pjesë e përmbajtjes së programit studimor të PDK-së për zhvillimin e Republikës së Kosovës, i cili (program) do të sjellë arritje të reja ekonomike e politike të funksionimit të shtetit ligjor.

Si përmbyllje e këtij vështrimi mund të thuhet: programi i ri i PDK-së, sa i pasur aq edhe motivues, nxiti e tërhoqi edhe shumë aderime të reja në PDK si: të reja e të rinj, intelektualë të formatit sipëror, specialistë dijesh të ndryshme etj. ndër të cilët edhe dr. Shqiptar Demaçin, i biri i personalitetit zulmëmadh përmasash gjithëkombëtare e ndërkombëtare, i luftëtarit shkëmb i pathyeshëm për lirinë e Kosovës- Adem Demaçit.

Shqiptar Demaçi e Andin Hoti (i biri i Ukshin Hotit) nuk e zgjodhën rastësisht PDK-në për të dhënë kontributin e tyre politik e kombëtar, porse zgjodhën partinë e dalë nga lufta çlirimtare, partinë me platformën reale të zhvillimit e të funksionimit të shtetit të mbështetur në të dhënat faktike e shkencore të ngritjes ekonomike të Kosovës, të luftimit të korrupsionit e të dukurive të tjera negative, partinë që kultivon raportet e bashkëpunimit të ngushtë në radhë të parë me ShBA-në e BE-në etj.

Nuk ka zhvillim të arsimit cilësor sepse në ballë të tij janë vënë njerëz pa kompetencë të duhur arsimore që nuk dinë të shprehen si duhet në gjuhën standarde shqipe, andaj ç'arsim cilësor mund të pritet nga të paarsimuarit, të cilët, ç'është për keqardhje, sot e drejtojnë arsimin e shtetit madje MAShT-i prin nga punësimet politike sipas kriterit partiak;

nuk ka njohje të reja të shtetit të Kosovës sepse është ngritur çështja e lëvizjes së kufijve Kosovë-Serbi, e cila me të drejtë krijoi dilema se në ç'kufij të njihet Kosova shtet; sigurisht se nuk njihet shtet nga shtetet e tjera një vend që luan me kufijtë e vet në të cilët është shpallur shtet sovran dhe është njohur nga njëqind e pesëmbëdhjetë shtete; pra, ndërprerjes së njohjeve i kanë paraprirë vetë drejtuesit e shtetit etj.

Dhe jo vetëm kaq. Pasi nuk ka përgjegjësi ligjore për veprat kriminale si rrjedhojë e mosfunksionimit të institucioneve të drejtësisë, shpërdorimet korruptive janë shtrirë edhe në veprimtari të tjera p. sh.: në gjykata, të cilat aktakuzat e ngritura nga prokurorët për veprat penale kundër zyrtarëve të lartë të shtetit, ku nga ndërhyrja e politikës e ku nga korrupsioni, i fshehin dhe i mbajnë në sirtarë me vite të tëra me qëllim që të vjetrohet lënda dhe kështu t'i shpëtohet dënimit.

Këshilli Prokurorial, ditë më parë, nuk lejoi praninë e ambasadorit britanik për të ndjekur korrektësinë e zbatueshmërisë së kritereve të zgjedhjes së kryeprokurorit special me gjithë marrëveshjen pararendëse që e kishin. Përse? Për arsye se politika e kishte paraparë se cili do të jetë ai. Pra, ai që do t'i përfillë qëndrimet e politikës!

### Korrupsioni më i fortë se ligji!

Në fushën e shëndetësisë ka disa vjet që është bërë publike dhe është dëshmuar me fakte afera e madhe korruptive e stentave nga e cila ndiqen shumë mjekë që shkelën betimin e Hipokratit dhe etikën mjekësore duke e vënë në rrezik jetën e njerëzve që kërkuan ndihmën e mjekut. Ka shumë kohë që drejtësia nuk merret me këtë krim, i cili mbrohet nga korrupsioni që në Kosovë është më i fortë se ligji.

Kriminaliteti është shtrirë edhe në fushën e rendit e të sigurisë, aty nga duhet të burojë gatishmëria për të ndjekur e për të zbuluar krimin; në polici lejohet të punojnë zyrtarë policorë që ndiqen për veprat penale, të pamoralshëm dhe me aktakuza për vepra të dhunshme.

Sa ka vërtetësi në përmbajtjen e shprehjes metaforike: "Do të ndërtojmë ura edhe aty ku nuk ka lumë", po aq janë reale edhe premtimet e disa liderëve mashtrues që i bëjnë në fjalime të ndryshme publike.

Po të mbahet parasysh përmbajtja e citatit të shkrimtarit e oratorit elitar W. v. Gëtes: "Nacionalisti më i mirë është ai që i dallon të metat e popullit të vet", e cila (përmbajtje) është me vlerë të përhershme, atëherë përpara strukturave intelektuale e akademike, përpara familjeve të dëshmorëve të kombit, përpara ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe të Kushtetutës së shtetit etj., del si obligim i pashmangshëm moral e kombëtar që të reagohet bashkërendueshëm në variante të ndryshme demokratike kundër veprimtarive: korruptive, kriminale, anarkike, diskriminuese etj. që sot mbizotërojnë në Kosovë.

Duke iu referuar citatit të Gëtes, cilat janë të metat e popullit tonë, parë nga rrethanat e sipërthëna? Ato janë: pasiviteti, heshtja e pajtueshmëria me tatëpjetën politike, ekonomike, arsimore, shëndetësore, korruptive, kriminale etj., të cilat sa vijnë e po thellohen duke e rrezikuar kështu edhe sovranitetin e shtetit. Populli ynë hëpërhë del të jetë vrojtues indiferent i deformimeve të këtilla. Ai, i manipuluar nga propaganda e interesit politik dhe e pretendimeve për pushtet të filistinëve karrieristë, nuk kundërshton politikën retrograde e stagnuese që drejtohet e ndiqet nga: narcistët e eristikët, nga rabulistët e poltronët e të tjerë të këtillë etj.

Gëte me të drejtë vuri re se nacionalistët e vërtetë vihen në shërbim të popullit për t'i mënjanuar gabimet, dështimet e të metat e tij. Në kontekstin e trajtimit tonë vlen të mbahet parasysh edhe thënia e politikanit të formatit më të lartë të demokracisë e të politikës botërore - Xhon Kenedi: "Liria pa dituri është gjithmonë në rrezik.!''

Pragmasemantika e citatit në vështrim, shumë kontemplativ e persuasiv, është tejet e qëndrueshme në ecurinë e politikës intrinstike dhe, si rrjedhojë e kësaj, edhe e politikës ekstrinstike në Kosovë. Sepse, qeveritarëve të lartë të Kosovës u mungojnë dituria e korrektësia e drejtimit të shtetit, e qeverisjes dhe e përfaqësimit të shtetit në relacionet ndërkombëtare. Beogradi zyrtar përfitoi nga ky diletantizëm politik i pushtetarëve të Kosovës të cilët, në fillim, gabuan rëndë që pranuan hyrjen në të ashtuquajturin dialog "teknik", por që ishte e doli dialog politik, me shtetin që nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur. Andaj, politika e Beogradit thoshte se po "bisedon shteti me provincën e vet!" Ky qe gabim i madh i udhëheqësve të lartë të Kosovës ngase vetë e degraduan shtetin. Në dialog me Beogradin Kosova u vu në pozicion inferioriteti nga deficiti i kognicionit politik të drejtuesve të shtetit. Ndonëse me vonesë, por duhet të korrigjohet ky gabim dhe të kërkohet që dialogu të zhvillohet midis dy shteteve: Kosovë-Serbi dhe jo shtet-provincë. Kjo sa i takon politikës së jashtme.

Mirëpo, në Kosovë ka edhe probleme të tjera të politikës së brendshme, të cilat nuk mund të zgjidhen nga ata që i krijuan për favore oligarkësh për t'i përforcuar pozicionet politike duke krijuar kështu situata të ndera stagnuese në fushat më të rëndësishme të veprimtarisë nga mosfunksionimi i ligjshmërisë.

Për tejkalimin e kësaj gjendjeje, imponohet ndryshimi, të cilin mund ta bëjë vetëm sovrani që është populli. Për këtë arsye është e domosdoshme që nga qarqet akademike, intelektuale, nga mediet etj. të zhvillohet veprimtari e thukët në terren me të gjitha shtresat e qytetarëve me anë të së cilës (veprimtari) do të pasqyroheshin me fakte gabimet, dështimet, keqpërdorimet, aferat korruptive dhe pasuritë enorme të paligjshme të qeveritarëve të lartë të shtetit, sidomos të dhjetë viteve të fundit, të cilat janë bërë tema delikate trajtimi kritik edhe në nivelin ndërkombëtar si p. sh. pensionet e veteranëve mashtrues e falsifikues që u miratuan nga Komisioni qeveritar, nga eprorë ushtarakë etj.

**(Vijon)**

## Themelohet Qendra për Karrierë në Malishevë



MALISHEVË, 25 SHTATOR (ER) - Është themeluar Qendra për Karrierë në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Komunën e Malishevës. Në ceremoninë e themelimit të kësaj qendre kanë marrë pjesë kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori i DAE-s, Blerim Thaçi, Katrin Ochsenbein, këshilltare Rajonale për Ekonomi dhe Punësim, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC), Fikrije Zymberi, ushtruese e detyrës së drejtorit të përgjithshëm, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr), Valbona Rraci, zyrtare e lartë e projektit EYE si dhe paneli nga Vushtrria, Gjakova dhe pronarë të bizneseve.
Me këtë rast, Begaj ka falënderuar Ambasadën e Norvegjisë për kontributin e dhënë për ndërtimin e objektit të kësaj qendre si dhe për trajnimet profesionale të mësimdhënësve që ka ofruar në Norvegji. "Kam edhe vlerësime pozitive për ekipin udhëheqës të shkollës, sukseset e nxënësve. Kjo Qendër për Karrierë që po inaugurohet sot është edhe një aset shtesë, për nxënësit tanë që të aftësohen për tregun e punës e kjo do të bëhet në bashkëpunim edhe me bizneset prodhuese, brenda komunës dhe jashtë saj e, pse jo, nxënësit tanë të janë të përgatitur si gjithë bashkëmoshatarët e tyre evropian", ka thënë Begaj.
Drejtori i Qendrës për Karrierë, Nazmi Zogaj, ka thënë se kjo qendër do të ndihmojë rreth 600 nxënës të kësaj shkolle për të zhvilluar një karrierë të suksesshme arsimore, profesionale dhe jetësore si dhe për ndërlidhjen më të mirë me tregun e punës.

# Komuna e Ferizajt shpërndanë mekanizëm bujqësor për fermerët



FERIZAJ, 25 SHTATOR (ER) - Në vazhdën e projekteve mbështetëse Komuna e Ferizajt, përmes Drejtorisë së Bujqësisë, ka bërë shpërndarjen e një sasie të mekanizimit bujqësor për disa nga fermerët ferizajas. Me këtë rast është thënë se vlera e këtij projekti kap shumën e 70 mijë eurove.
Kryetari i kësaj komune, Agim Aliu, ka thënë se përkushtimi i institucioneve karshi kësaj kategorie mbetet prioritet. Madje këtë përkushtim Aliu ia ka adresuar drejtorisë e cila me ndryshimet që ka bërë në politikat e këtij sektori dita-ditës po i fuqizon edhe më shumë veprimtaritë bujqësore. "Drejtoria e Bujqësisë dhe drejtori edhe gjatë hartimit të platformës sonë qeverisëse pikërisht ka ndryshuar, dizajnuar këto politika mbështetëse në mënyrë që të krijojnë efekte direkte dhe jo që diçka që mund të quhet abuzive. Ka qenë zotim yni që do të mbështeten ata fermerë që janë me të vërtetë të përkushtuar për t'u marrë me veprimtari bujqësore", ka thënë Aliu.
Ndërsa fermeri Basri Avdyli nga fshati Softaj e ka vlerësuar këtë përkrahje të komunës, duke thënë se ky mekanizëm i hyn në funksion. "Ne kemi nevojë për mekanizëm dhe ky është projekt më se i qëlluar. Fuqizimi i këtij sektori kërkon përkrahje tëvazhdueshme", ka thënë Avdyli. Në anën tjetër, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Burim Bajrami, ka thënë se me këtë projekt po synohet të krijojnë lehtësira kualitative për fermerët e Ferizajt.

# Gjilani nesër organizon garën e atletikës për fëmijë



GJILAN, 25 SHTATOR (ER) - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjilanit, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Federatës së Atletikës së Kosovës, nesër (e premte) do ta organizojnë garën e atletikës për fëmijë. Ushtruesja e detyrës e kësaj drejtorie, Deniza Limani, ka deklaruar se aktiviteti i llojit të tillë organizohet për herë të parë në Gjilan dhe ka për qëllim që fëmijët e klasave të pesta t'i argëtojë nëpërmjet aktivitetit fizik dhe lojërave, ndërkaq mbahet në stadiumin ndihmës. "Secili fëmijë do të kalojë në stacionet e 12 lojërave gjatë programit dhe aktiviteti nuk do të jetë i karakterit garues. Qëllimi është argëtimi i fëmijëve, por edhe mundësia e fëmijëve që t'i paraqesin aftësitë e tyre lëvizore. Programi në vete pasqyron vlerat e aktivitetit fizik, disiplinës, respektit, socializimit andaj mund të themi se ka edhe karakter edukativ", ka deklaruar Limani. Në këtë aktivitet fëmijët do ta kenë mundësinë që brenda dy orëve të praktikojnë shumë disiplina të përafërta të sportit të atletikës në 12 stacionet e aktivitetit. Ky program i atletikës për fëmijë është realizuar në shumë kryeqytete dhe qytete të ndryshme të botës dhe është i njohur me emrin "Kids Athletics".

## Përfundojnë punimet e asfaltimit të disa rrugëve të fshatrave të Drenasit

DRENAS, 25 SHTATOR (ER) - Komuna e Drenasit ka bërë me dije se lista e projekteve të investimeve kapitale për këtë vit është në fazën përfundimtare në realizimin e projekteve të planifikuara. Sipas kësaj komune mbi 80 projekte të planifikuara janë në fazën përmbyllëse të punimeve. "Kështu kanë përfunduar asfaltimet e rrugëve në lagjet e fshatrave: Korroticë e Epërme, Zabel i Ulët, Poklek i Ri dhe i Vjetër, Sankoc, Fushticë e Ulët dhe e Epërme, ku gjatësia e këtyre rrugëve në lagjet e fshatrave të lartpërmendura është mbi dy kilometra. Në disa lagje të këtyre fshatrave është bërë edhe rregullimi i rrugëve me zhavorr", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



## Putini takon Maduron në Moskë



MOSKË, 25 SHTATOR - Presidenti rus, Vladimir Putin, është takuar me homologun e vet nga Venezuela, Nicolas Maduro, në Moskë, në kohën kur qeveria e këtij të fundit po përballet me krizë të vazhdueshme politike. Rusia ka qenë një prej shteteve më të shpejta që i ka ofruar atij mbështetje, teksa ai është përballur me ato që janë përshkruar si përpjekje të Shteteve të Bashkuara për ta dëmtuar atë. Pavarësisht prej krizës së thellë politike dhe ekonomike të Venezuelës, Moska ka vazhduar të ofrojë kredi në mbështetje të Maduros.
Putini dhe as Maduro nuk kanë diskutuar për ndihmë financiare në deklaratat e tyre publike. Mirëpo presidenti rus ka përmendur se Rusia ka investuar 4 miliardë dollarë në Venezuelë.
Putini, po ashtu, i ka thënë Maduros se Rusia mbështet dialogun në mes të qeverisë dhe opozitës, në mënyrë që të gjendet zgjidhje për krizën politike të Venezuelës.
Ndaras agjencia ruse e lajmeve, "Interfax", ka raportuar se Rusia planifikon ta furnizojë Venezuelën me 600 000 tonë grurë këtë vit.
Vizita e Maduros vjen një ditë pasi presidenti i ShBA-së, Donald Trump, i ka nisur paralajmërim Venezuelës, duke përmendur Maduron në fjalimin e tij në Kombet e Bashkuara.
Opozita e Venezuelës ka thënë më herët gjatë këtij muaji se dialogu i ndërmjetësuar nga Norvegjia në tentim të zgjidhjes së krizës në Venezuelë tashmë ka mbaruar, gjashtë javë pasi qeveria e Maduros ka pezulluar pjesëmarrjen. Përfaqësuesit e Maduros janë larguar nga tavolina e bisedimeve në muajin gusht për të protestuar kundër sanksioneve të ashpra të Trumpit ndaj Karakasit.

# Hetimet për ngritjen e akuzave me qëllim shkarkimin e Trumpit

Kryetarja demokrate e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, njoftoi fillimin zyrtar të hetimeve pasi u bë i ditur pretendimi i një informatori se presidenti Trump i pati bërë presion presidentit të Ukrainës për ta hetuar familjen e rivalit të tij politik, Joe Biden


ASSOCIATED PRESS

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Janë 173 ligjvënës amerikanë që janë deklaruar deri më tani në mbështetje të procesit hetimor për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Kryetarja demokrate e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, njoftoi fillimin zyrtar të hetimeve nëse presidenti Trump pati kërkuar ndihmën e një qeverie të huaj për rizgjedhjen e tij vitin e ardhshëm. "Zëri i Amerikës" nga Kongresi njofton për hapat më të fundit të legjislativit pasi u bë i ditur pretendimi i një informatori se presidenti Trump i pati bërë presion presidentit të Ukrainës për ta hetuar familjen e rivalit të tij politik, Joe Biden.
Një pikë kthese për presidencën Trump. "Dhoma e Përfaqësuesve do të fillojë një hetim zyrtar akuzash për shkarkim. I udhëzova gjashtë komisionet tona t'i vazhdojnë hetimet e tyre nën këtë çadër. Presidenti duhet të japë llogari. Askush nuk është mbi ligjin", njoftoi Nancy Pelosi, kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve.
Janë shtuar gjasat që presidenti Trump të bëhet presidenti i katërt amerikan që përballet me procesin e ngritjes së akuzave për shkarkimin. Ai nuk mohoi se pati penguar asistencën e miratuar nga Kongresi për Ukrainën. "Fondet u dërguan plotësisht. Unë jam ankuar gjithnjë më parë dhe do të vazhdoj t'i pezulloj fondet deri në çastin që Evropa dhe vendet e tjera të kontribuojnë për Ukrainën, gjë që nuk e kanë bërë", tha presidenti Trump.
Të dhënat e nxjerra nga një informator krijuan një valë ligjvënësish demokratë që njoftonin mbështetjen për procesin e shkarkimit të presidentit nëpërmjet hetimit në Kongres. "Nuk mund të vonohemi. Nuk mund të presim. Tani është koha të veprojmë", deklaroi ligjvënësi demokrat John Lewis.
Irritimi i tyre arriti kulmin pas muajsh debati mes demokratëve nëse veprimet e presidentit përbënin bazë për shkarkim. "Ka pasur shumë akte flagrante, por asgjë nuk krahasohet me këtë. Presidenti po na thotë se 'po, unë bashkëpunova me fuqi të huaja. E çfarë do të bëni juve?'", tha ligjvënësi demokrat Tom Malinowski.
Aleatët e presidentit në Kongres thanë se lëvizja e Pelosit është vetëm çështje fjalësh. "Nuk e vendos dot ajo e vetme nëse kemi filluar një hetim për shkarkim. Ato që tha sot nuk ndryshon asgjë në rrjedhën e ngjarjeve të deritanishme", tha Kevin McCarthy, udhëheqës i pakicës republikane në Dhomën e Përfaqësuesve.
Megjithatë, republikanët në Senat i bashkuan votat me demokratët për ta kërkuar bërjen publike të denoncimit të informatorit. "Nëse presidenti nuk bashkëpunon, por vazhdon ta pengojë Kongresin dhe ta shpërfillë ligjin, atëherë ai nuk do t'i lërë zgjidhje tjetër Kongresit përveç ngritjes së akuzave për shkarkimin. Kjo do të ishte një tragjedi, e shkaktuar nga vetë presidenti", tha Joe Biden, kandidat demokrat për president.
Ligjvënësit demokratë thonë se kjo është një krizë e sigurisë kombëtare që duhet t'i shqetësojë të gjithë amerikanët, megjithëse shumica e tyre nuk e mbështesin procesin e shkarkimit. "Nuk mendoj se presidenti duhet t'i pengojë ndihmat për një vend, në mënyrë që të mbledhë informacione dëmtuese për kundërshtarët e tij. Kjo është antikushtetuese dhe ne kemi mundësinë tani ta bëjmë të qartë këtë gjë", tha ligjvënësja demokrate Ilhan Omar.
Komisionet e Kongresit që mbulojnë çështjet e zbulimit pritet të dëgjojnë këtë javë dëshminë e informatorit, ndërkohë që Dhoma e Përfaqësuesve do t'i vijojë procedurat hetimore.

## Kina kundërshton presionin e Uashingtonit për tregtinë



PEKIN, 25 SHTATOR - Kina i bëri thirrje të mërkurën presidentit Donald Trump që t'i dëgjojë vendet në zhvillim dhe të shprehet kundër presionit pasi udhëheqësi amerikan kritikoi Pekinin në Kombet e Bashkuara mbi çështje tregtare.
Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Geng Shuang, i bëri thirrje presidentit Trump për gjetjen e "një rruge të mesme" për mosmarrëveshjet mes dy vendeve.
Dy qeveritë janë ngërthyer në një luftë tarifash që është përshkallëzuar lidhur me pretendimet e Uashingtonit mbi suficitin tregtar të Kinës si dhe për presion ndaj kompanive amerikane për të dorëzuar të dhëna mbi teknologjinë. Mosmarrëveshjet kërcënojnë ta fusin ekonominë botërore në recesion.
Të martën Trumpi u ankua se Organizata Botërore e Tregtisë po i jep Kinës në mënyrë të papërshtatshme trajtim preferencial. Ai u referohej ankesave se Kina po abuzon me kufirin e dhënë vendeve në zhvillim për t'i subvencionuar eksportet apo vonesat në hapjen e tregjeve.
Negociatorët amerikanë dhe kinezë pritet të takohen në tetor për raundin e 13-të bisedimeve që synojnë t'i japin fund luftës tregtare. Deri tani nuk ka pasur asnjë shenjë përparimi që nga koha kur bisedimet u bllokuan në muajin maj.

# LIBËR ME INTERES GJUHËSOR DHE LETRAR

*(Sadik Bicaj, "Vështrime gjuhësore dhe letrare", Klubi Letrar "Podguri", 2019)*

**Shkruan: Maxhun OSMANAJ**

Sadik Bicaj, gjuhëtar, poet, publicist, gazetar dhe pedagog shumëvjeçar: lexuesve arriti t'u ofrojë një libër me interes për gjuhësinë dhe letërsinë shqipe për fëmijë. Autori tashmë ka një përvojë botimi qoftë të librave gjuhësorë, qoftë publicistikë, andaj në mënyrë kronologjike në kapitullin e parë "Vështrime gjuhësore" trajton prejardhjen, formimin, drejtshkrimin, gjuhën standarde, problemet drejtshkrimore në media të shkruara dhe të folura, gabime drejtshkrimore të nxënësve në dy shkollat më të mëdha të Komunës së Istogut si dhe disa gabime të hetuara në gramatikat e klasave VI, VII, VIII dhe IX të autorit prof. dr. Bahri Beci. Ndërsa redaktori gjuhësor i këtij libri, mr. Skënder R. Hoxha, thekson: "Këto tema hedhin dritë në shumë çështje fonetike, morfologjike dhe sintaksore, ku autori zë ngoje përdorimin e trajtave dialektore, përdorimin e zanores ë, shenjat e pikësimit, ndarjen (gabimisht) të fjalëve në rrokje në fund të rreshtit, etj. (f. 196).

Në kapitullin tjetër "Vështrime letrare" jep disa vlerësime me interes për disa vepra letrare për fëmijë. Bicaj është ithtar dhe dashamirës i përdorimit të drejtë të gjuhës shqipe kudo: si në shkollë, shoqëri, media dhe në të folurit e përditshëm. Pra, përdorimin e fjalëve shqipe në vend të atyre serbokroate, turke apo çfarëdo gjuhe tjetër qoftë. Marrja me aspekte gjuhësore dhe puna si pedagog mësimdhënës i gjuhës shqipe për një kohë të gjatë, ia ka mundësuar një njohje më të thellë të këtyre problemeve gjuhësore që i hasim sot kudo. Ndërsa recensenti i librit në fjalë, dr. sci. Valdet Hysenaj, thekson: "Në këtë dritë autori kap edhe kriteret ekstralinguistike si: shtrirja gjeografike e popujve dhe gjuhëve, shkollat gjuhësore të kohës, themelvënësit e hulumtimeve gjuhësore: Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti, Rexhep Ismaili, Xhevat Lloshi, Isa Bajçinca, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Ragip Mulaku, Hysen Matoshi etj" (f. 198). Në kapitullin "Vështrime letrare", Bicaj trajton në aspektin vlerësues disa libra të rëndësishëm për fëmijë që shënojnë prurje të reja nga pionierët e kësaj letërsie dhe pa këto vepra dhe autorë, letërsia shqipe për fëmijë do të ishte tepër e varfër në aspektin cilësor, tematik dhe stilistik. Kështu autori ndalet te tema "Figura e Skënderbeut në disa vepra të letërsisë shqipe", ku me një vështrim të shkurtër panoramik zë ngoje veprat "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit, "Skënderbeu i pafanë" i Jeronim de Radës, "Istoria e Skënderbeut" e Naim Frashërit, "Historia e Skënderbeut" e Fan Nolit, "Kështjella" e Ismail Kadaret, "Skënderbeu" i Sabri Godosë, "Trimi i mirë me shokë shumë" i Sulejman Pitarkës, "Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun" i Naum Priftit. Bicaj vazhdon me poezinë e Migjenit, ku bën një analizë të thuktë të "Vargjeve të lira", poezi dhe prozë. Autori me referenca të shumta plotëson mendimin e pasur kritik për veprën e poetit letrar për romanin "Droja" të njërit prej autorëve më emblematik të letërsisë shqipe për fëmijë, Rifat Kukaj. "Droja" është kryevepra letrare e Rifat Kukaj si dhe një ndër romanet më të mira në letërsinë shqiptare për fëmijë në përgjithësi" (f. 125).

Autori ndalet te pionieri i letërsisë shqipe për fëmijë, Rexhep Hoxha, përkatësisht te romani "Verorja", ku me një vlerësim kritik dallon veçantitë, ndërtimin, stilin figurativ, personazhet dhe fabulën e këtij libri, kryevepër të autorit Hoxha dhe mbarë letërsisë shqipe për fëmijë. Ai merr në trajtim edhe romanin "Shpella e piratëve" të autorit të mirënjohur Petro Marko. Autori nuk harron as studiuesin e mirënjohur, dr. Xhevat Syla, duke dhënë një vlerësim mjaft të pjekur për librin "Kush e shkruan poezinë (vlerësime për letërsinë për fëmijë)".

Në fund autori trajton edhe disa poetë të letërsisë së sotme për fëmijë dhe të rritur. Në një kumtesë të "Flakës së janarit", mbajtur në Pejë, Bicaj thekson disa veçori të atdhetarit dhe shkrimtarit Jusuf Gërvalla, ku mes të tjerash thekson: "Gërvalla në poezinë e tij shpreh fuqishëm dashurinë, dhimbjen dhe mallin për vendlindjen, shtëpinë dhe nënën, ndërsa edhe vetmia është e pranishme në disa poezi të tij" (f. 171).

Ndërsa recensenti tjetër i librit, Maxhun Osmanaj, ndër të tjera, për vlerën e këtij libri thekson: "Një veçori e trajtimit të romanëve në fjalë është ngase ai përzgjedh këto kryevepra të letërsisë shqipe për fëmijë dhe ndalet në një analizë të hollësishme dhe analitike, çka është një lehtësi për lexuesin" (f. 2001). Autori ka plotësuar librin me referenca të gjuhëtarëve, shkrimtarëve dhe kritikëve, pra ka vjelë material të mjaftueshëm për një libër me interes për nxënës, të fillores, gjimnazit dhe studentëve.

Ky libër do t'i shërbejë çdo mësimdhënësi për ta pasur si pronë të pasur intelektuale në bibliotekat e veta. Bicaj në librin "Vështrime gjuhësore dhe letrare" dëshmon se është fanatik, kërkues i problemeve gjuhësore dhe krijues i zellshëm letrar. Autorit i dëshirojmë shëndet dhe suksese të reja në krijimtari gjuhësore dhe letrare.



E jashtëzakonshme

# Kapet nëndetësja me rreth 165 milionë dollarë kokainë



Anëtarët e ekuipazhit të Rojës Bregdetare të Valiantit kanë kapur një nëndetëse me rreth 5 500 kilogramë kokainë në bord. Nëndetëset e drogës u kushtojnë trafikantëve nga 1 deri në 2 milionë dollarë për t'u prodhuar, por vlera e kokainës që transportojnë është shumë e lartë. El Kapos, po ashtu, i janë kapur nëndetëse.

FOTO E DITES




Fëmijët luajnë me një celular në një treg në New Delhi në Indi. /AFP/

E rrallë

# Makina luksoze për fëmijë, duke filluar nga 30 mijë euro



Edhe të vegjlit tanimë mund ta drejtojnë një makinë luksoze për vetëm 30 mijë euro. "Bugatti" ka prezantuar një model automjeti për fëmijë, që është sa një e katërta e përmasave origjinale. Makina "Bugatti Baby II" mund të drejtohet edhe nga të rriturit. Modeli final, i cili u krijua për herë të parë në vitin 1927-1936 si makinë lodër për fëmijë, u prezantua gjatë festimeve të përvjetorit të 110 të firmës.

## BARSOLETA E DITËS



**- Mami, mami, shokët tallen me mua. Më thonë se kam këmbë shumë të mëdha.**
**- Bëjnë shaka, shpirti i mamit, mos ua vër re! Hajt tash, shko parkoji këpucët në garazh se do të hamë drekë.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Çdo ditë në ora 16:00**

## Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley







**Në ora 18:00 dhe 20:00**

## AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray

**Çdo ditë në ora 22:00**

## DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nëse jeni në çift mos merrni vendime impulsive gjatë kësaj dite sepse shumë shpejt do të pendoheni.



**DEMI**
Priten disa probleme të vogla në çift gjatë kësaj dite, kështu që tregohuni më të matur me fjalët dhe veprimet.



BINJAKËT
Falë konfigurimit jo të mirë të Neptunit ka rrezik që jeta juaj në çift të jetë e mbushur me probleme dhe debate në ditën e sotme.



**GAFORRJA**
Dielli do të ndikojë pozitivisht sot në jetën tuaj dhe do ta krijojë ambientin më harmonik.



**LUANI**
Jeta juaj në çift do të shkojë për mrekulli gjatë kësaj dite. Shijojeni në maksimum.



VIRGJËRESHA
Do të jeni shumë xheloze për atë që keni në krah gjatë kësaj dite dhe mund të bëni disa skena që nuk do t'i pëlqejnë partnerit.



PESHORJA
Edhe pse mund të keni disa debate me partnerin tuaj gjatë kësaj dite, çdo gjë do të rregullohet në shtrat.



**AKREPI**
Gjatë kësaj dite ata që janë në një lidhje nuk do të kenë as tabu dhe as gjëra të ndaluara.



SHIGJETARI
Pas një periudhe jo edhe shumë të mirë për jetën në çift, sot do të bëni gjithçka që keni në dorë për të krijuar një ambient të ngrohtë.



**BRICJAPI**
Ju që jeni në një lidhje nuk do të jeni aspak të duruar dhe mund të bëni gabime sot.



**UJORI**
Sot priten ndryshime të mëdha në jetën tuaj në çift, prandaj kini kujdes të madh se si silleni me bashkëshorten.



**PESHQIT**
Konfigurimi i yjeve do ta bëjë jetën në çift edhe më të bukur sot se çdo ditë të derisotme tuajën.

# Charlie Sheen për pak të ishte pjesëmarrës i Dancing With the Stars



Charlie Sheen tregoi se në këtë sezon planifikoi të merrte pjesë në Dancing With the Stars, madje ishte planifikuar që t'i fillonte provat, por diçka e ndaloi. "Isha shumë i nderuar nga oferta e ABC-së, por në fund të ditës unë i kam dy këmbë të majta dhe thjesht nuk mund të kërcej", ka pohuar Charlie për US Weekly. "ABC bëri një ofertë shumë bujare" tha publicisti, duke shtuar se "kishte kushte në lidhje me pjesëmarrjen në Dancing With the Stars".

# Jenna Dewan po pret fëmijë me të dashurin



Jenna Dewan është shtatzënë. Aktorja po pret fëmijën e parë me të dashurin Steve Kazee. "Ne jemi shumë të kënaqur dhe nuk mund të jemi më të lumtur se kaq që po zgjerojmë familjen tonë", thanë ata në një deklaratë për "People". Ky do të jetë fëmija i parë për Steven, por Jenna është nënë e një vajze gjashtëvjeçare me emrin Everly, të cilën e ka me ish-burrin Channing Tatum. Lajmi i mirë vjen vetëm disa javë pasi Jenna dhe Steve shijuan një pushim romantik në Kaliforni.



# Çfarë po ndodhë mes Khloes dhe Tristanit?

Tristan Thompsoni së fundmi shkroi një koment në fotografinë e Khloe Kardashianit në "Instagram". Kur Tristani pa imazhin, ai shkroi: 'e përsosur', së bashku me një figurë në formë të zemrës. Fansat shpejt vunë re komentin, por ai vendosi ta fshijë. Edhe pse Khloe dhe Tristan u ndanë në fillim të këtij viti, pasi ai u kap duke e tradhtuar me Jordyn Woodsin, duket sikur marrëdhëniet e tyre janë të mira.

# Brad Pitt vjen në rolin e astronautit



Pas pjesëmarrjes në konkurs në Festivalin e fundit të Filmit në Venecia, Ad Astra tashmë ka dalë edhe në ekranin e madh, përfshirë këtu kinematë shqiptare. Është një triller fantashkencor, i drejtuar nga James Gray. Protagonist është Brad Pitti, në rolin e një astronauti që udhëton deri në ekstremet e sistemit diellor për ta gjetur babanë e vet, i zhdukur prej kohësh, dhe për të zbuluar një mister që kërcënon mbijetesën e planetit tonë. "Më pëlqejnë shumë punët e James Grayt. E admiroj njohjen e tij të thellë të historisë së kinemasë. Ka gjithnjë një element klasik në narracionet e tij, shumë elegant", ka thënë Pitti.




Sport




# Sahiti: Vëllaznimi shumë shpejt do të dalë nga kjo krizë

Futbollisti Samir Sahiti është rikthyer në KF Vëllaznimi pasi i ka kaluar dënimi për moslejim të paraqitjeve në ndeshje zyrtare nga Federata e Futbollit e Kosovës. Ai ka shprehur optimizëm se skuadra kuqezi do të dalë nga kjo krizë. "Vëllaznimi është një klub me traditë të madhe dhe shumë shpejt do ta gjejë rrugën për të dalë nga kjo krizë. Klubi e as qyteti i Gjakovës nuk e meritojnë këtë gjendje", ka thënë Sahiti



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 SHTATOR - KF Vëllaznimi është duke kaluar nëpër një periudhë jashtëzakonisht të vështirë pasi, përveç mungesës së rezultateve pozitive, ka edhe probleme financiare. Kjo nuk e ka penguar futbollistin Samir Sahiti të rikthehet në këtë klub. Ai ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se është rikthyer për ta ndihmuar klubin kuqezi për të dalë nga kjo situatë. "Të gjithë janë të njoftuar me situatën nëpër të cilën po kalon Vëllaznimi. Unë kam pasur një dënim nga Federata e Futbollit nga ndeshja e barazhit dhe ky dënim më ka kaluar dhe kam vendosur të rikthehem për t'i ndihmuar Vëllaznimit për ta kaluar sa më shpejt këtë krizë. Nganjëherë edhe ne si futbollistë duhet që t'i qesim në plan të dytë kushtet financiare", ka thënë Sahiti.

Ish-futbollisti i disa skuadrave në Kosovë dhe jashtë saj ka thënë se skuadra gjakovare ka traditë të madhe në futbollin e Kosovës dhe shumë shpejt do t'iu rikthehet rezultateve pozitive. "Vëllaznimi është një klub me traditë të madhe dhe shumë shpejt do ta gjejë rrugën për të dalë nga kjo krizë. Klubi e as qyteti i Gjakovës nuk e meritojnë këtë gjendje", ka shtuar ai. "Momentalisht nuk jam në gjendjen më të mirë fizike, sepse më duhet të përgatitem edhe pak që të jam në formën maksimale dhe me pas synojë të jap kontributin tim për klubin e Vëllaznimit", ka deklaruar Sahiti, i cili me skuadrën e Ligës së Parë ka kontratë deri në janar të vitit 2020. Skuadra e Vëllaznimit ndeshjen e fundit e humbi në derbin e Rrafshit të Dukagjinit kundër Besës së Pejës (2-0), kurse në përgjithësi nga pesë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar tri barazime dhe dy humbje, duke u renditur në pozitën e parafundit me tri pikë. Ndeshjen e radhës kjo skuadër e zhvillon të dielën nga ora 15:00 ndaj Malishevës në Gjakovë.

# Hajrizi: Rikthimi i Pejës, i rëndësishëm për basketbollin e Kosovës



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Edicioni i ri pritet të jetë shumë interesant në basketbollin e Kosovës. Tifozët pritet t'i mbushin palestrat derisa do të ketë edhe shumë derbi.

Rikthimi i Pejës në garat e elitës është një arsye dhe motiv që ky edicion pritet të jetë shumë interesant. Verdhezinjtë kanë bërë shumë përforcime me lojtarë vendorë dhe të huaj në mënyrë që të kenë një paraqitje sa më të mirë në Superligë.

Një nga basketbollistët kryesor pa dyshim është Drilon Hajrizi. Ai flet për synimet e Pejës në këtë edicion dhe për rëndësinë që ka rikthimi i saj në elitë. "Pa dyshim se rëndësia është shumë e madhe. Besoj se Peja do t'i japë një shije të mirë basketbollit të Kosovës dhe është mirë për basketbollin e Kosovës që është rikthyer. Do të ketë më shumë derbi dhe më shumë shikues. Realisht ne kemi filluar më vonë përgatitjet dhe do të jetë një edicion i vështirë, sepse Peja ka pushuar për një vit. Ka bërë shumë përforcime dhe ekipi duhet të komponohet. Fillimi do të jetë i vështirë. Por, mendoj se më shumë ka rëndësi si e përfundojmë sesa si e nisim. Shpresoj se do të kemi një stinor shumë të mirë në garat e elitës", ka thënë Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së.

Pejës i është hequr dënimi nga FIBA dhe mund të transferojë lojtarë. Pikërisht për këtë arsye mungoi vitin e kaluar në Superligë. Në xhiron e parë pejanët do të jenë mysafirë të Ponte Prizrenit në përballjen që zhvillohet të dielën me fillim nga ora 17:00.

## Këndellet Prishtina, vetëm dy pikë larg liderit

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - FC Prishtina, me emërimin e Armend Dallkut në postin e trajnerit, ka filluar të këndellet dhe të ngrihet në renditjen tabelore në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Kryeqytetasit e mposhtën skuadrën e Dukagjinit (2-0) tri ditë pasi e kishin mposhtur edhe Gjilanin (2-1) në stadiumin "Fadil Vokrri". Në minutën e shtatë golin e parë në ndeshje për Prishtinën e shënoi mesfushori Meriton Korenica, i cili pas një harkimi me kokë realizoi për 1-0. Gjashtë minuta pasi filloi pjesa e dytë për 2-0 u përkujdes Leonit Abazi. Rastet nuk munguan edhe në vazhdimin e ndeshjes nga të dyja skuadrat, por gola të tjerë nuk pati. Pas kësaj ndeshje skuadra "bardhekaltër" ngrehet në pozitën e gjashtë me 10 pikë, dy pikë më pak se Feronikeli dhe Gjilani që ndajnë dy pozitat e para. Ndërsa Dukagjini, edhe pas gjashtë xhirosh, është skuadra e vetme që nuk ka shënuar fitore e as gol, kurse ka grumbulluar vetëm një pikë.



## Mekaj duhet të operohet



RAHOVEC, 25 SHTATOR - Basketbollisti i KB Rahovecit, Leonard Mekaj, ka pësuar një lëndim të martën në ndeshjen me Sigal Prishtinën për Superkupë. Mekaj ka thënë për faqen zyrtare të FBK-së se ka pësuar frakturë të dyfishtë në hundë dhe për këtë arsye duhet të operohet. "Mjekët e kanë konstatuar se kam pësuar frakturë të dyfishtë. Duhet t'i nënshtrohem operimit dhe më pas të kthehem në parket. Ende nuk e di saktë se kur do të jem në gjendje të luaj, pasi fillimisht varet nga operimi dhe më pas faza rehabilituese. I falënderoj të gjithë për përkrahjen që më kanë dhënë", ka thënë Mekaj për faqen e FBK-së.

# Rashkaj: Talentin e kemi në gjak

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Mesfushori i Kosovës, Anel Rashkaj, beson se talenti i futbollistëve të Kosovës dhe përvoja e fituar në ndeshjet kualifikuese për Botëror i ka ndihmuar "Dardanët" t'i sigurojnë sukseset e fundit përkundër vështirësive financiare.



Anel Rashkaj ka luajtur në tri nga pesë ndeshjet e Kosovës në Grupin A për kualifikim në Kampionatin Evropian 2020, duke luajtur mesatarisht 22 minuta për ndeshje. Kosova radhitet e treta në këtë grup, mirëpo ka gjasa të mira për ta siguruar kualifikimin në "Euro 2020", pasi është vetëm një pikë prapa Republikës Çeke, me të cilën do të përballet më 14 nëntor. "Arsyeja pse po ecim mirë është se gjithmonë Kosova ka pasur lojtarë të mirë. Një arsye tjetër është përvoja e fituar në kualifikueset e Botërorit, për të mos e harruar edhe mbështetjen fantastike që marrim nga shqiptarët e Kosovës në mbarë botën", u shpreh Rashkaj. "Këto janë arsyet pse kemi arritur në pikën që ta pretendojmë një vend në 'Euro 2020'. Ne besojmë te kualifikimi. Pse jo?! Për sa kohë diferenca me Çekinë është e vogël, gjithçka është e mundur", ka deklaruar ai.

Rashkaj e lavdëroi edhe trajnerin Bernard Challandes, i cili kishte shkuar 15 ndeshje pa asnjë disfatë, para se ta humbte ndeshjen e fundit të zhvilluar, atë kundër Anglisë me rezultat 5-3. "Mendoj se ai është një trajner shumë i mirë. Është mënyra e vetme për t'i motivuar futbollistët. Ai, gjithashtu, merr vendime të mira dhe të drejta për përfaqësuesen", ka shtuar Rashkaj.

Më tej, mesfushori foli edhe për Kosovën e para dhjetë vjetëve, kur lojtarët nuk kishin as fanella për stërvitje. "Kam lëvizur drejt Suedisë që në moshën 14-vjeçare, por e kam përfaqësuar Kosovën për herë të parë në vitin 2009. Atëherë ne ende nuk ishim pranuar nga FIFA dhe UEFA. Mbaj mend që 10 vjet më parë nuk kishim rroba për t'u stërvitur dhe tani jemi pjesë e këtij suksesi. Të gjitha këto lojëra janë shumë motivuese për mua dhe jam shumë i lumtur", ka shtuar mesfushori.

Rashkaj në fund u pyet se si ka mundësi që Kosova ka kaq shumë talente dhe sqarimi i vetëm i kosovarit ishte se këtë e kanë në gjak. "Është e vështirë të japë një shpjegim sepse në Kosovë gjithnjë ishte e vështirë sa i përket anës ekonomike, ndërsa kampionati nuk ishte edhe aq cilësor. Nuk mund t'ju them ndonjë mënyrë se si punuam për të dalë në pah të gjithë këta futbollistë. Mendoj se e kemi në gjak talentin tonë", ka përfunduar Rashkaj.

# Reja: Kualifikimi është i vështirë, varet nga ndeshja me Turqinë

TIRANË, 25 SHTATOR - Trajneri i Shqipërisë, Eduardo Reja, në një intervistë për "Tuttomercatoweb", ka dhënë opinionin e tij për futbollistët kuqezinj që luajnë në Serinë A. 72-vjeçari italian foli edhe për eliminatoret e "Euro 2020" dhe mundësitë që ka Shqipëria për t'u kualifikuar. Trajneri italian e lavdëroi formën e Hysajt për formën e mirë, por fjalë të mira patë edhe për mbrojtësin Berat Gjimshiti. "Tani për tani Hysaj nuk është prekur nga mosaktivizimi te Napoli. Ai shënoi një gol të bukur kundër Islandës. Unë dua ta shfrytëzoj nga mesfusha e lart dhe Hysaj po dëshmon se është shumë i aftë edhe në këtë qasje taktike. Rritja e Gjimshitit? E kam pasur lojtar edhe vite më parë. Ai ishte një futbollist i mirë. Tani është më i pjekur, po bën më shumë se mirë tek Atalanta. Aty ka qenë gjithmonë një nga më të mirët. Pavarësisht prej vështirësive mbrojtëse, Gjimshiti është gjithmonë mjaftueshëm në rolin e tij".



Trajneri Reja mendon se kualifikimi varet nga ndeshja me Turqinë. "Fitorja kundër Islandës: Kualifikimi do të jetë i vështirë, do të varet shumë nga rezultati që do të marrim në Turqi. Ne duhet ta fitojmë këtë transferim, plus ndeshjen tjetër kundër Moldavisë, gjithmonë larg shtëpisë, që të kemi shpresë. Përndryshe, bëhet e vështirë", ka deklaruar ai.

Strategu italian që në të kaluarën e drejtoi skuadrën e Lazios ka shprehur mendimin se shqiptarët janë të kënaqur me lojën që po e aplikon kombëtarja kuqezi. "Grupi ynë nuk është i lehtë, Franca është mbi të tjerat. Islanda është, gjithashtu, një ekip i mirë, por e merituam fitoren e fundit ndaj saj. Ne po bëjmë një punë të mirë, kam ndryshuar shumë lojtarë, duke futur të tjerë, që dëshmuan se e meritonin më shumë. Ne po përparojmë. Në Shqipëri thonë se kurrë nuk kanë parë të luajnë futboll si ky. Shpresoj se mund të bëjmë edhe më mirë", ka përfunduar Reja.

## SHKURT

### Grezda mund të transferohet në Katar ose Australi

Karriera e Eros Grezdës me Rangersin është mbyllur, të paktën derisa në krye të jetë Steven Gerrardi. Trajneri i njohur e ka shprehur hapur se sulmuesi nuk mund të jetë më pjesë e ekipit skocez. Kontrata e Grezdës me Rangersin është deri në vitin 2022 dhe nuk mund të presë kaq gjatë pa luajtur. Për më tepër edhe transferimet në Evropë janë mbyllur sa i përket afatit kalimtar të verës. "TRT Football" shkruan se Katari është një nga opsionet më të mira për këtë futbollist. Kjo pasi merkato atje mbyllet më 30 shtator dhe janë vetëm 2 skuadra që nuk e kanë plotësuar kuotën e lojtarëve të huaj. Kampionët e Al Sadd dhe Al Rayyan janë dy ekipet që mund ta marrin Grezdën dhe që kanë më shumë shanse për momentin. Një alternativë B konsiderohet Australia, atje ku merkato mbyllet më 15 tetor dhe ku së fundmi është zyrtarizuar edhe Migjen Basha.

### Presidenti i La Ligas: Messi është lojtari më i mirë në histori

Javier Tebas e vlerëson lart yllin e Barcelonës, Lionel Messi, i cili, sipas tij, është lojtari më i mirë në histori. Messi mori për herë të parë çmimin e Lojtarit më të Mirë të FIFA-s për Meshkuj, përpara Virgil van Dijk dhe Cristiano Ronaldo, në Milano të hënën. Fituesi i pesë herë "Topit të Artë", Messi ka një rekord mahnitës duke fituar 34 tituj me Barcelonën nga viti 2004. Debati se kush është lojtari më i madh shpesh është përqendruar te Messi, Ronaldo, Diego Maradona dhe Pele, por Tebas nuk ka dyshime. Sipas presidentit të La Ligas, ylli argjentinas i katalunasve është lojtari më i mirë në histori. "Ai është lojtari më i mirë në histori. Ne jemi me fat që e kemi në La Liga. Nuk mund ta imagjinoj një kampionat pa Messin. Ai ka lindur në ligën spanjolle dhe shpresoj që ai ta përfundojë [karrierën] këtu", ka thënë presidenti i La Ligas.

### Unitedi rikthen interesimin për Mandzukiqin

Skuadra e Manchester Unitedit e ka rikthyer interesimin për sulmuesin e Juventusit, Mario Mandzukiq. Sulmuesi kroat nuk është në planet e trajnerit Sarri dhe mundësia që të largohet në janar është e madhe. "The Independent" zbulon se e ardhmja e ish-sulmuesit të Bayern Munchenit dhe Atletico Madridit do të jetë në Premierë Ligë.

### Bayerni kërcënon Gjermaninë: Neueri është i paprekshëm

Në debatin se kush duhet të jetë portieri i parë i Kombëtares së Gjermanisë, presidenti i Bayernit, Uli Hoeness, ka kërcënuar ta dëmtojë "imazhin sportiv" edhe me një bojkot ndaj ekipit të DFB. Kur u pyet nëse situata midis Manuel Neuerit dhe Marc-Andre ter Stegen i kujton atij edhe rastin e vitit 2006 mes Lehmann dhe Oliver Kahn, Hoeness u përgjigj: "Jo. Por ne kurrë nuk do të pranojmë që të ketë një ndryshim. Nëse kjo ndodhë, ne nuk do t'i dërgojmë lojtarët e Bayernit në ekipin kombëtar. Ter Stegen është portier i mirë, por më i mirë dhe më me përvojë është Neueri", ka thënë Hoenessi.

### Ja ku do të zhvillohen tri finalet e ardhshme në Ligën e Kampionëve

